

Atraksionet turistike në Komunën e Drenasit

Nr.	Emërtimi	Përshkrimi i atraksionit	Kategoria	Adresa	Komuna
1	Liçeni i Vasilevës	Gjeneron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim të ekoturizmit ku mund të organizohet peshkimi, ecja në natyrë, çiklizmi malor etj. Në këtë mënyrë ofrohet mundësia që vizitorët të shijojnë bukuritë e natyrës dhe të gjejnë pushim në brigjet e freskëta të liçenit e sidomos në ditët e nxehta të verës.	Atraksion natyror	Vasilevë	Drenas
2	Parku i pishave të Kamenicës	Ky park me një sip. 59.4ha gjeneron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim të ekoturizmit ku mund të organizohet dhe ecja në natyrë, freski në këtë ambient pushime etj.	Atraksion natyror	Gllobar	Drenas
3	Guri i Plakës	Monument i natyrës nënkuptohet shkëmbi dhe sipërfaqja prej 5 ari e cila e rrethon shkëmbin. Monumenti është i ndarë në mes nga Hekurudha Fushëkosovë – Pejë	Atraksioni natyror	Dobroshec	Drenas
4	Malet e Qyqavicës	Malet e Qyqavicës janë të njohura për bukuritë e tyre, ofrohen mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit malor dhe dimëror, ecje çiklizëm malor etj. Në këto hapësira mund të hasen këto lloje të botës shtazore: Dhelpra (Vulpes vulpes), Ujku (Canis lupus), Ariu i murmë (Ursus Arctos), Vjedulla (Meles Meles), Ketri (Sciurus vulgaris), Lepuri (Lepurus europeus), Sqardhi, Derri i egër (Sus strofa) etj.	Atraksion natyror	Drenas	Drenas
5	Malet e Berishës	Malet e Berishës janë të njohura për bukuritë e tyre, ofrohen mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit malor dhe dimëror, ecje në natyrë çiklizëm malor etj. Në këto hapësira mund të hasen këto lloje të botës shtazore: Dhelpra (Vulpes vulpes), Ujku (Canis lupus), Ariu i murmë (Ursus Arctos), Vjedulla (Meles Meles), Ketri (Sciurus vulgaris), Lepuri (Lepurus europeus), Sqardhi, Derri i egër (Sus strofa) etj	Atraksion natyror	Drenas	Drenas
6	Trungu i Dushkut (6 lisat)	Trungu i dushkut në Likashan është monument i natyrës i karakterit botanik nënkupton trungun e dushkut me hapësirën përfshirëse të projeksonit të kurorës dhe zonës buferike prej 5m rreth projeksonit të kurorës. Zona e mbrojtur përfshinë sipërfaqen prej 5 ari. Trungu ka lartësinë e kërcellit prej 20m dhe vjetërsi afër 200 vjet. Është vendi i fillimit të betejës së parë ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe ku dhe fillon lufta për çlirimin e Kosovës. Vizitohet nga qytetarët e vendeve të ndryshme të Kosovës.	Atraksion natyror	Likoshan	Drenas
7	Shtëpia muze e familjes Ahmeti	Është shtëpi muze në të cilën ka ndodhur masakra e parë në Kosovë e cila tmerroi botën e civilizuar përendimore ishte vendi i fillimit të betejës së parë ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, në këtë shtëpi u nxorën të gjithë meshkujt dhe u masakruan. Vizitohet nga qytetarët e vendeve të ndryshme të Kosovës.	Atraksion kulturor	Likoshan	Drenas
8	Shtëpia muze e familjes Muqolli	Në këtë shtëpi është kryer masakra më makabre e forcave të Policisë dhe Ushtrisë Serbe ndaj civilve të pa armatosur dhe në fund janë djegur të gjithë.	Atraksion kulturor	Poklek i vjeter	Drenas
9	Kalaja e Vuçakut	Kalaja e Vuçakut Gradina ka një pozicion dominant dhe strategjik. Ajo ka komunikim vizual me Gradinën e Llandroniqit dhe të Llapushnikut në jug, Gradinën e Kievës në perëndim dhe malin e Shishavicës në lindje. Gradina e madhe ka trajtën e një kodre trungkonike me sipërfaqe të sheshtë dhe eliptike. Diametri i saj lindje-perëndim është 82m ai veri-jug është 55m dhe sipërfaqja rreth 0.5ha. Vizitohet nga qytetarët e vendeve të ndryshme të Kosovës.	Atraksion kulturor	Vuçak	Drenas

10	Kalaja e Vërbocit	Kalaja ka pas të gjitha elementet e një kështjelle; rrugicat, varrezat, vendbanimet, vendet mbrojtese, vendsulmimet të cilat kanë konstatuar aty kanë jetuar fiset ilire. “Kalaja e Vërbocit ka qënë urë lidhëse e fiseve dardane dhe ilire në mes të kalasë së Mitrovicës, të kalas së Vuçakut për të vazhduar nderlidhjet me kalatë e Rrafshit të Dukagjinit” Vizitohet nga qytetarë të cilët dalin në mënyrë të organizuar në grupe.	Atraksion kulturor	Vërboc	Drenas
11	Kulla e Shaban Polluzhës	Monumenti i Kullës së Shaban Polluzhës është ne proces te ndërtimit për nderë të luftës së Drenicës në Krye me Shaban Polluzhën kundër sistemit okupues komunist të Jugosllavisë. Është në Listën e Monumenteve të Mbrojtura.	Atraksion kulturor	Polluzhë	Drenas
12	Kulla e Xhemajl Abrisë	Kjo Kullë është në Broshurën e trashëgimisë kulturore të Drenasit (2015) për nderë të Patriotit dhe Pleqnarit të Kosovës Xheamail Abria i cili ishte pjesmarrës i takimit në Kuvendin e Junikut në vitin 1877, ku edhe u nderua me titullin, " <i>Pleqnar i Kosovës</i> " e gjithashtu ishte edhe pjesmarrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878) gjë që ndikoi në rritjen e autoritetit të tij. Në Kuvendin e Parë të Pajtimeve, mbajtur pas Kuvendit të Lidhjes së Prizrenit, të cilën e udhëhiqte Binak Alia, Drenicën e përfaqsonte Xheamail Abria. Kulla është e tipit P+1+K., është monument i trashëgimisë Kulturore Arkitekturale.	Atraksion kulturor	Abri	Drenas
13	Stacioni trenit Dobroshec	Në rrugën hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë -Drenas– Pejë, në fshatin Dobroshec gjendet stacioni i hekurudhor i Trenit i ndërtuar për gravitimin e banorëve të fshatit Dobroshec, dhe të fshatrave për rreth. Gjatë luftës së viteve 1998/99 ka qenë shtab i Batalionit të parë të brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”, në muajin mars të vitit 1999 gjatë ofensivës është djegë dhe shkatërruar nga forcat serbe. Pas luftës në këtë stacion është gjiruar filmi “ Tri Dritare “ Është në listën e monumenteve të Trashegimisë Kulturore të Kosovës.	Atraksion kulturor	Dobroshec	Drenas